



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

Java Kundër  
**KORRUPSIONIT**  
3-9 DHJETOR 2017

# KONFLIKTI I INTERESIT NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS



#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:  
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE

**INPO**  
INSTITUTI I NJËZEMTËSIAVE  
POLITIKE

INSTITUTI I NJËZEMTËSIAVE  
POLITIKE **gapan**



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

**COLUMBUS**

**ÇOHU!**

**KIPRED**

Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi

*Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.*



*Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.*

## RRETH IKD

*IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.*

## IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Hulumtimet janë përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

## Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive.....	3
II. Përshkrim i rastit.....	4
III. Gjetjet konkrete.....	8
IV. Pyetjet publike .....	9

## I. Përmbledhje ekzekutive

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) gjatë vitit 2015 është përcjellë me shumë polemika dhe paqartësi lidhur me zgjatjen e mandatit ligjor të disa anëtarëve KPK-së, respektivisht mandatin e znj. Sevdije Morina, anëtare e KPK-së nga PSRK, dhe z. Jetish Maloku, anëtar i KPK-së nga Prokuroritë Themelore.

Edhe përkundër faktit se ligji kishte përcaktuar se mandati i anëtarit të KPK-së është pesë vjeçar pa mundësi vazhdimi, KPK gjatë vitit 2015, kishte vendosur që edhe përkundër kësaj të vazhdoj mandatin e dy anëtarëve të KPK-së, znj. Morina dhe z. Maloku. Znj. Morina kishte qëndruar si anëtare e KPK-së për afërsisht pesë vite e nëntë muaj, kurse z. Maloku kishte qëndruar për afërsisht 5 vite e pesë muaj.

Si znj. Morina ashtu edhe z. Maloku, kishin marr pjesë në diskutim dhe kishin votuar lidhur me zgjatjen e mandatit të tyre. Votimin për zgjatjen e mandatit për vete, i cili krijon fuqi në mundësinë e vendimmarrjes për politikën e sistemit prokurorial, përfshi edhe beneficionet tjera të të qenit anëtar i KPK-së paraqiste situatë të konfliktit të interesit. Aso kohe, partnerët ndërkombëtar si Ambasada Amerikane dhe projekti i Bashkimit Evropian që e mbështesnin KPK-në kanë dhënë opinione me shkrim se pjesëmarrja në diskutim dhe votimi për vetën bie në kundërshtim me ligjin. EULEX-i kishte pasur qëndrim të kundërt.

Korniza ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës ka përkufizuar qartë gjendjen e konfliktit të interesit, në të cilën mund të gjenden personat zyrtar.

Neni 424 i Kodit Penal të Kosovës, përkufizon veprën penale të konfliktit të interesit, kur “personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”

Sipas Kodit, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare. Përderisa, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër.

Kurse, neni 6 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka përkufizuar konfliktin e interesit, si gjendje e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta,

personale ose pasurore, te cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Edhe Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e KPK-së në nenin 3 përcakton se: “Anëtari i Këshillit mbanë përgjegjësinë për të shmangur konfliktin e interesave në bazë të marrëdhënieve familjare apo shoqërore në pajtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave. Dhe se në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit mëson për ndonjë konflikt interesi apo për çfarëdo rrethana të tjera që mund të ngrenë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do i ndërpret të gjitha veprimtaritë mbi rastin dhe menjëherë njofton Kryetarin e Këshillit me shkrim në lidhje me atë situatë.”

Ngritja e këtyre dyshimeve lidhur me kryerjen e veprës penale të konfliktit të interesit gjatë takimit publik të KPK-së, kur këta dy anëtarë kishin diskutuar dhe votuar për vetën e tyre, nuk ishin trajtuar asnjëherë sipas ligjit nga Agjencia Kundër Korrupsion, Policia apo Prokurori i Shtetit.

Një veprim i tillë duhet të shqyrtohet nëse është shkelur Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Anëtarëve të KPK-së apo nëse është konsumuar vepra penale e konfliktit të interesit, e cila asnjëherë nuk është trajtuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe vetë organet e Prokurorisë.

## **II. Përshkrim i rastit**

Në një shoqëri demokratike ku zbatohen standardet minimale të mirëqeverisjes, çdo vendimmarrje duhet të bazohet në parime bazike siç janë pavarësia, paanshmëria dhe integriteti. Në çdo rast kur këto parime nuk gjejnë zbatim në praktikë në mënyrë kumulative, publiku vë në dyshim vendimet e miratuara nga institucionet publike.

Integriteti i një procesi vendimmarrës nënkupton se individi apo organi kolegjal gjatë marrjes së vendimeve nuk bëjnë asnjë kompromis lidhur me interesa të caktuara në raport me kolegët e tij apo me persona tjerë në jetën e tij private. Integriteti në vete nënkupton se individi është i ndershëm, punon në mirëbesim, është i drejtë në punën e tij, kur gjatë punës së tij bazohet në vlera që në publik dëshmojnë se i njëjti është objektiv, i trajton qytetarët në mënyrë të barabartë, zbaton në mënyrë të përpiktë ligjin, manifeston të publiku besim dhe siguri lidhur me ligjshmërinë e vendimit që merr. Integriteti në një proces gjyqësor nuk është vetëm një shprehje, është domosdoshmëri. Kur në praktikë nuk zbatohen këto parime gjatë procesit të vendimmarrjes në një shoqëri demokratike në publik kjo konsiderohet si veprim korruptiv.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> “Manual mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e drejtësisë, Përmbledhje tematike e politikave, standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare”. Faqe 7. (Shikuar për herë fundit 20.11.2017 [http://ceeliinstitute.org/wp-content/uploads/2015/05/FULL\\_VERSION\\_FINAL1.pdf](http://ceeliinstitute.org/wp-content/uploads/2015/05/FULL_VERSION_FINAL1.pdf))

Integriteti i anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës ishte debatuar gjatë në kohën e garës për Kryeprokuror të Shtetit dhe gjatë ngritjes së dilemave për zgjatjen e mandatit për dy anëtarët e Këshillit, znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku.

Më datë 28 maj 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar pakon e ligjeve të gjyqësorit, respektivisht plotësim ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ( LKGJK), Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës (LKPK), Ligjin për Gjykatat (LGJ) dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit (LPSH).

Plotësim ndryshimi i ligjeve të lartpërmendura ka paraparë ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga dy këshillat për zbatimin e obligimeve ligjore, lidhur me ndryshimet substanciale sa i përket procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përbërjes së re të KPK-së në pajtim me Kushtetutë dhe ligj, kalimin e Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, themelimin e komisioneve të reja të përhershme të Këshillit Prokurorial, etj.

KPK gjatë vitit 2015 është përcjellë me shumë polemika dhe paqartësi lidhur me mandatin ligjor të disa anëtarëve KPK-së, respektivisht mandatin e znj. Sevdije Morina, anëtare e KPK-së nga PSRK, dhe z. Jetish Maloku, anëtar i KPK-së nga Prokuroritë Themelore.

Përderisa, më 8 mars 2010, znj. Morina ishte emëruar anëtare në atë kohë e KGJK-së dhe njëkohësisht anëtare e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP), gjatë muajit mars 2011, znj. Morina ishte transferuar si anëtare në KPK të themeluar rishtazi, sipas nenit 43 të Ligjit për KPK, i cili kishte hyrë në fuqi më 1 Janar 2011.

Përderisa, z. Maloku më 15 korrik 2010, ishte emëruar anëtar në atë kohë i KGJK-së dhe njëkohësisht anëtar i KPGJP-së. Njëjtë edhe z.Maloku ishte transferuar si anëtar në KPK të themeluar rishtazi, sipas nenit 43 të Ligjit për KPK, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2011.

Ligji mbi KPK ka paraparë që mandati i anëtarëve të KPK-së, është pesë vjeçar pa mundësi vazhdimi.

Lidhur me mandatet e anëtarëve të lartpërmendur të KPK-së, kishin dhënë opinion edhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështesin KPK, respektivisht këshilltarët nga Ambasada Amerikane<sup>2</sup> dhe këshilltarët nga Projekti i Bashkimit Evropian për mbështetje Këshillit Gjyqësor

---

<sup>2</sup> *Shënim:* Analiza e Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara lidhur me mandatet e anëtarëve prokurorë kishte këshilluar KPK-në se “mandati i të dy anëtarëve të Këshillit nga KPGJP duhet të skadojë në mars 2015. Kjo paraqet skadimin e natyrshëm të mandatit të anëtarit të parë të emëruar. Pasi që të dyja mandatet fillojnë më emëruarin e parë atëherë edhe do të përfundojnë me skadimin e mandatit të të emëruarit të parë, dhe të dy mandatet duhet të përfundojnë në mars 2015”. (Ligji mbi përbërjen e përkohshme të KGJK-së, neni 7, paragrafi 1).

dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, të cilët kishin ardhur në përfundim se mandati i anëtarëve prokuror nuk mund të kaloj mandatin pesë vjeçar të përcaktuar me ligj.

Përderisa këshilltarët ndërkombëtar të EULEX-it që mbështesin KPK, kanë pasur qëndrim tjetër nga këshilltarët tjerë ndërkombëtarë dhe kanë rekomanduar vazhdimin e mandatit për znj. Morina dhe z. Maloku deri në vitin 2016.

Edhe përkundër rekomandimeve të këshilltarëve ndërkombëtarë nga Ambasada Amerikane dhe Bashkimi Evropian<sup>3</sup>, që e kanë mbështetur KPK, i njëjti Këshill kishte vendosur që anëtarëve jo prokurorë të iu vazhdoj mandatin znj. Morina dhe z. Maloku deri në fund të vitit 2015.

Respektivisht, znj. Morina, kishte qëndruar si anëtare afërsisht pesë vite e nëntë muaj, kurse z. Maloku, kishte qëndruar si anëtar afërsisht, pesë vite e pesë muaj, përderisa Ligji mbi KPK ka paraparë që mandati i anëtarëve të KPK-së, është pesë vjeçar pa mundësi vazhdimi.

Rekomandimi i EULEX-it dhe vazhdimi i mandatit të dy anëtarëve të KPK-së ishte diskutuar edhe në takimin e pestë plenar lidhur me Marrëveshjen për Stabilizim Associm mes Kosovës dhe BE-së, të mbajtur më 8 korrik 2015. Në këtë takim, z. Jean-Eric Paquet, Drejtor për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian është shprehur lidhur me zbatimin e pakos së ligjeve, duke theksuar: *“Ne mirëpresin miratimin e katër ligjeve që dalin nga Pakoja e gjyqësorit. Miratimi i legjislacionit është vetëm hapi i parë i ndryshimit të sistemit apo strukturës. Kosova tani ka nevojë të fokusohet në zbatimin rigoroz dhe të përshtatshëm të këtyre ligjeve”*. Z. Paquet ka ngritur shqetësimin lidhur me bazën ligjore të mandateve të disa anëtarëve të KPK-së.

KPK gjatë vendosjes së vazhdimit të mandatit të anëtarëve të kontestuar po ashtu kishte vepruar në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare. Gjatë vazhdimit të mandatit të këtyre anëtarëve të njëjtit kishin marr pjesë në procesin e diskutimit dhe votimit për të vazhduar mandatin e tyre. Ky veprim nga ana e anëtarëve të KPK-së ishte në kundërshtim me rekomandimin e këshilltarëve ndërkombëtarë që mbështesin KPK.<sup>4</sup> Anëtarët e KPK-së për të cilët ishte diskutuar zgjatja e mandatit kishin marr pjesë në diskutim dhe kishin mundësuar kuorumin për zgjatje të mandatit.

---

<sup>3</sup> *Shënim:* Këshilltarët ndërkombëtarë të projektit të Bashkimit Evropian që mbështesin Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, në opinionin e tyre lidhur me mandatin e anëtarëve prokurorë në KPK, kishin ardhur në përfundim se “pas analizimit të të gjitha fakteve relevante dhe kornizës ligjore të zbatueshme, Ekipi i Projektit nuk gjen argumente të mjaftueshme për të mbështetur ligjshmërinë e lejimit të mandatit shtesë njëvjeçar të kërkuar, për njërin nga anëtarët aktual të KPK të transferuar nga KGJK/KPGJP – Znj. Morina apo Z. Maloku”.

<sup>4</sup> Si përfundim, janë konflikte të qarta të interesit që duhen adresuar para zhvillimit të diskutimit dhe votimit. Së pari, asnjëri anëtar i KPK-së, mandati i të cilit është në pyetje nuk duhet të shërbejë në grup punues për përgatitjen e analizës ligjore për dorëzim në Këshill. E dyta, asnjë anëtarë, mandati i të cilit është në pyetje nuk duhet lejuar të marrë pjesë në asnjë diskutim dhe votim mbi mandatin e tyre. Me qëllim të ruajtjes së kuorimit për shqyrtimin dhe votimin final, dy çështjet duhen trajtuar si të ndara. Për mandatin e prokurorëve, asnjëri nga të dy nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në diskutim dhe votim.” Analiza e Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.

KPK deri në fund të vitit 2015, me përbërje të kontestuar dhe me mandate të kundërligjshme të anëtarëve të KPK-së, kishte miratuar rregullore, vendime dhe dokumente tjera të cilat në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën ishin kontestuar, pasi që të njëjtat ishin marr në kundërshtim me hierarkinë e akteve normative në Kosovë.<sup>5</sup>

Për këtë situatë të konfliktit të interesit, në kohën e polemikave në KPK, kishte kërkuar përgjigje nga AKK, ish-Kryesuesi i KPK-së, z. Sylë Hoxha. Në një përgjigje të AKK-së, zyrtarët e saj, kishin theksuar dispozitat ligjore të situatave të konfliktit të interesit të anëtarëve të KPK-së.

“Duke u përgjigjur në imiellin tuaj dhe pyetjen e bërë nga ana juaj që lidhet me: pjesëmarrjen, diskutimin dhe votimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kur lidhet me mandatin e tyre personal dhe se a përben shkelje dhe a është në pajtim me ligjin për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

- Ju informojmë se bazuar në neni 6 të Ligjit 04./L-051, Konflikti i Interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.
- Andaj bazuar në këtë nocion dhe duke u bazuar në Parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë të paraparë sipas nenit 7 dhe pikës 7.8 të Ligjit 04./L-051, Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.
- Njëherësh neni 13 pika 1,2 e Ligjit 04./L-051: Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publikë, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinë paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Po ashtu është obligim i cilit do anëtar të KPK-së që të respektoj nenin 3 pika 4.5.6 të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e KPK-së që lidhet përgjegjësinë për të shmangur dhe evituar konfliktin e interesit, i miratuar më 31 korrik 2012.”

Për më tepër, këto dispozita që i ka cituar AKK rreth Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale të KPK-së, të cilët obligohen t'i respektojnë përcaktojnë se:

---

<sup>5</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 13. (Shih linkun <https://mapl.rksgov.net/getattachment/4eb17bf0-695f-4a4b-bce6-101e66ba55c9/Raporti-per-Kosoven-2015.aspx> )

- Anëtari i Këshillit mbanë përgjegjësinë për të shmangur konfliktin e interesave në bazë të marrëdhënieve familjare apo shoqërore në pajtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.
- Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit mëson për ndonjë konflikt interesi apo për çfarëdo rrethana të tjera që mund të ngrenë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do i ndërpret të gjitha veprimtaritë mbi rastin dhe menjëherë njofton Kryetarin e Këshillit me shkrim në lidhje me atë situatë.
- Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit, e fshehtë, respektivisht nuk e raporton ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit apo çfarëdo rrethane tjetër që mund të ngritë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj/ por ndonjëri nga anëtarët e Këshillit ka njohuri për këtë rrethanë, do të ishte e detyrueshme për këtë anëtarë që këtë rrethanë t'ia raportojë Kryetarit të Këshillit.

Sidoqoftë, AKK në një përgjigje për IKD, ka kthyer përgjigjen e dërguar aso kohe Kryetarit të KPK-së, z. Sylë Hoxha, por nuk është përgjigjur se pse nuk e ka trajtuar rastin.<sup>6</sup>

IKD për të gjitha këto çështje të ngritura ka kërkuar përgjigjur prej znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku, por ata janë përgjigjur.<sup>7</sup>

### III. Gjetjet specifike

- KPK ka shkelur nenin 5 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, lidhur me zgjatjen e mandatit të anëtarëve znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku;
- Znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e konfliktit të interesit të përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës dhe Ligjin mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik;
- Znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e konfliktit të interesit të përcaktuara në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e KPK-së.
- Gjatë vitit 2015, kur anëtarët e KPK-së znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku kanë qëndruar me mandat të kontestuar në KPK, Këshilli ka miratuar vendime shumë të rëndësishme për sistemin prokurorial të Kosovës, përfshirë, emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit, emërimin e anëtarëve të rinj të KPK-së, përfundimin në mënyrë të kundërligjshme të anëtarit të shoqërisë civile, emërimin e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, miratimin e një numri të rregulloreve dhe politikave nga KPK, etj.

<sup>6</sup> IKD ka kërkuar përgjigje zyrtare prej Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Shaip Havolli, i cili është përgjigjur përmes postës elektronike. Nëntor 2017.

<sup>7</sup> IKD rreth kësaj teme ka kërkuar përgjigje zyrtare pwrmes postws elektronike dhe telefonit prej znj. Sevdije Morinës, Zv/Kryeprokurore e Shtetit dhe z. Jetish Maloku, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore të Gjilanit. Nëntor 2017.

- IKD publikisht kishte raportuar lidhur me këto shkelje në KPK.
- KPK, Prokurori i Shtetit, Policia e Kosovës dhe Agjencia kundër Korrupsion asnjëherë nuk kanë informuar publikun nëse është ndërmarr ndonjë veprim lidhur me këtë çështje.

#### **IV. Pyetjet publike**

- *Pse KPK ka lejuar anëtarët znj. Sevdije Morina dhe z. Jetish Maloku të vazhdojnë të qëndrojnë si anëtarë të Këshillit edhe pas skadimit të mandatit të ligjshëm?*
- *Pse Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të hetimit të dyshimeve për kryerjen e veprës penale të konfliktit të interesit nga anëtarët e KPK-së që kanë diskutuar dhe votuar për vetën e tyre, rrjedhimisht për beneficionet e tyre?*
- *Pse Policia e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të hetimit të dyshimeve për kryerjen e veprës penale të konfliktit të interesit nga anëtarët e KPK-së që kanë diskutuar dhe votuar për vetën e tyre, rrjedhimisht për beneficionet e tyre?*
- *Pse Prokurori i Shtetit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të hetimit të dyshimeve për kryerjen e veprës penale të konfliktit të interesit nga anëtarët e KPK-së që kanë diskutuar dhe votuar për vetën e tyre, rrjedhimisht për beneficionet e tyre?*